



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2010/2011

## TESTI 2

# GJUHË SHQIPE

### UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për punë janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjesh, të shkruash diçka etj.

Gjithnjë përdor emërtimet e plota me rastin e zgjidhjes së detyrave, shkurtesat nuk janë të lejueshme (psh., duhet të shkruash: rrethanori i vendit, e jo rr.v.).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.

Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps.

Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

**Të dëshirojmë sukses në provim!**



**1.** Lexoje tekstin dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

Drita

I. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike në llambë duhet të shndërrohet në dritë e jo në nxehtësi. Për këtë përdoren tela shumë të hollë që nuk shkrihen lehtë e që nxehen deri në 2000 oC. Me qëllim që të mos lëshojnë nxehtësi të madhe, telave u jepet forma e spirales. Oksigjeni, i cili në këtë temperaturë do të digjte menjëherë telin, nxirret jashtë llambës. Në të futet azot.

II. Ndërkohë nata ra si një tym i zi dhe mbulloi luginat. Format e tokës nuk mund të njiheshin më. Po tani ndriçonin yjet e fshtrave që i përgjigjeshin njëri-tjetrit. E gjithë toka ishte mbuluar nga përshëndetjet e dritave. Çdo shtëpi ndizte yllin e saj para natës së pafund, ashtu si fari përpara detit të paanë...

Thuani cili stil është përdorur në tekstin e parë e cili në tekstin e dytë:

- a) stili i letërsisë artistike
- b) Stili politiko-shoqëror
- c) Stili shkencor-technik.
- d) Stili administrativo-juridik.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

**2.** Edhe pse jo shumë i njohur për opinionin kosovar, Patrick Nou do të jetë njëri nga tre anëtarët e jurisë së emisionit të talentëve gjermanë, i ngjashëm si “American Idol” në SHBA, “Deutschland Sucht Den SuperStar”.

Shqiptari i lindur në Zvicër, Patrick Nou, i cili ka prejardhje nga Gjakova, gëzon famë të jashtëzakonshme në Evropën e Mesme, ndërsa tani do të jetë përkrah legjendës gjermane Dieter Bohlen dhe këngëtares tjetër Fernanda Bardao në spektaklin e televizionit gjerman RTL, i cili transmetohet çdo të shtunë dhe të mërkure.

Nou është bërë i njohur me hitet e tij “5 Days” dhe “Beautiful”, ndërsa nuk e ka lënë pas as modelimin, ku ishte jashtëzakonisht i suksesshëm. Ai ishte i martuar me yllin hollivudian, Mally Schade

- a) Ku ka lindur shqiptari, Patrick Nou?
- b) Shkruaj cilat janë hitet e tij më të njohura?
- c) Me kë ishte i martuar ai?

### 3. Lexo me vëmendje:

Na ishte një herë një mbret ilir që kishte një vazë shumë të bukur, ende të pamartuar. Mbreti qiti fjalë se do të organizonte një garë për të gjithë princat e rinj dhe të pamartuar të Ilirisë dhe të vendeve përreth, dhe atij që do të dilte më shenjtari nga kjo garë, do t'i takonte e bija e tij. Së shpejti, gara u organizua ndërsa mbreti urdhëroi që për shenjë të vihej një mollë.

Pastaj u shfaqën princat me shigjeta dhe pallat që shkëlqenin dhe, nga një distancë e afërt, të gjithë e goditën mollën; në distancën tjetër, vetëm dy princa ia dolën ta godisnin mollën, princi tartar dhe ai dardan. Ndërsa herën e tretë, mollën e goditi vetëm shigjeta e princit dardan dhe kështu, ai e mori për nuse çikën e mbretit, me bekimin e shkëlqesisë së tij, Mbretit.

Teksti i mësipërm është ndarë në:

a) kapitull

b) paragraf

c) titull

### 4. Detyra: Lexo me vëmendje tekstet e dhëna dhe përgjigju pyetjeve:

Lexo tekstin dhe nënvizo fjalinë e cila nuk është e rëndësishme për kuptimin e tekstit.

Përdorimi i Ligjit të Arhimedit

Konstruksioni i objektit lundruer siç është nëndetësja në pajtim me Ligjin e Arhimedit. Vetë konstuksionin e nëndetësës e ka bërë shkrimtari francez, Zhill Vern, në romanin “Njëzet mijë milje nën det”. Nëndetësja mund të zhytet dhe të dalë në sipërfaqe në saje të dhomave që i ka. Përmes vrimave në dhoma lëshohet uji i cili përmbush dhe kështu e shton peshën e nëndetësës. Nëndetësja atëherë fundoset. Në kundërshtim me këtë, pesha e nëndetësës zvogëlohet me nxjerrjen e ujit nga dhomat. Atëherë nëndetësja del mbi ujë. Në këtë mënyrë ndryshon pesha e nëndetësës, përderisa forca e shtypjes mbetet gjithnjë e njëjtë. Kur nëndetësja del në sipërfaqe, për shkak të zvogëlimit të peshës së saj, zvogëlohet edhe forca e saj shtypëse.

### 5. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm:

Jeronim de Rada

KËNGË PËR VDEKJEN E SKËNDERBEUT

Cila erë do ta rrëmbejë vallë këtë trup? O, sa orë hareje shpresoi ai dhe s'pati kurrë! Të rrethuar nga rrufe e dallgë ne s'dimë ku iku toka: mbetëm ne në këto vise. Pse, moj re, ti çahesh dhe hap një qiell të bardhë mbi viset e vendlindjes?

Edhe veriu fryn më fortë dhe duke na harruar shkon mbi det. Ndofta nuk e di se për fatin tonë të zi ne jemi brengosur. Ja, lindi agimi i vendit tim. Po shoh prapë fushat e zbehta dhe kodrat thethezeza: ja shtëpia e nënës sime, ja gratë e rritura me mua, që, të ngritura pa gdhirë, dalin në dritaret e shtëpive të vështrojnë detin. Ato janë të brengosura se Skënderbeu u bë dhe. Kur u nisa unë, më pyesnin: “O

Serafinë, a ke vallë një nënë që të të presë në breg dhe të të shtrëngojë me duart që i dridhen, gjymtyrët e tua të freskëta? Apo do të jesh e vetmuar atje si toka që njerëzit e shkelin me këmbë dhe s'ë vënë re?"

Kambanat mbrëmë kumbonin në zi në të gjitha brigjet se heroi vdiq: dhe ja, nëpër altare u shuan qirinjtë, veç drita e vatrës i ndriçoi shtëpitë: Në ëndërr ishin bërë mospërfillëse ndaj tokës së mbjellë me pemë dhe hënë. Medet! Nga dheu nuk ngrihet më ai, në fushim vetëm çadra e tij mungon....

Po pse vallë, kur dielli u shua në mal, vajtuam se kishim humbur rrugën dhe vetë dielli mbeti pa vajtim?....

Autori rrëfen:

a) ngjarje të përjetuar

b) ngjarje të dëgjuar

**6.** Shkruaj drejt me shkronja të dorës këtë fjali:

Bleta para se të bëjë mjaltin bën dyllin

\_\_\_\_\_

**7.** Rretho shkronjën para fjalisë e cila është shkruar sipas rregullave të drejtshkrimit.

a) S'foli për njëme me mua tërë natën.

b) Në detyrën e më të mirë që e kam ba spat parregullsi.

c) Frutat që i morëm nuk kenë me shije.

d) Të gjithë më kërkuan derisa nuk më gjetën se ku isha fshehur.

**8.** Shkruaj me shkronja këta numra:

48

\_\_\_\_\_

128

\_\_\_\_\_

500

\_\_\_\_\_

XII

\_\_\_\_\_

**9.** Nëse është theksuar vetia tipike për gjuhën e folur, në vijë pranë saj shkruaj “F”, kurse nëse është tipike për gjuhën e shkruar, shkruaj “SH”:

- a) Realizohet në dialog. \_\_\_\_\_  
 b) Plotësohet me gjeeste dhe me mimikë. \_\_\_\_\_  
 c) Fjalitë i ka më të gjata dhe më të ndërlikuara. \_\_\_\_\_

**10.** Nëse shkurtesa është shkruar si duhet, në vizën pranë saj shëno S, e nëse nuk është shkruar saktë, shkruaj G.

etj (e të tjera) \_\_\_\_\_

Nr. (numër) \_\_\_\_\_

psh. (për shembull) \_\_\_\_\_

dr. (doktor) \_\_\_\_\_

fq (faqja) \_\_\_\_\_

**11.** Shiko fjalinë e mëposhtme dhe nënvizo theksin e fjalive:

– Sa do të rrish? Ku ndodhet shpata e Skënderbeut?

– Jepjani Andit ta vizatojë.

Në cilat fjalë bie theksi te fjalitë pyetëse dhe te fjalitë urdhërore?

Nënvizoni theksin në fjalitë e mësipërme:

\_\_\_\_\_

**12.** Trego se cilës pjesë të ligjëratës i takojnë fjalët e nënvizuara në fjalinë e dhënë:

Libri i vogël ndodhet nën tavolinë.

(Shkruaj për secilën fjalë se cilës pjese të ligjëratës i takon)

**13.** Çfarë kuptimi kanë fjalët e mëposhme:

a) influencë \_\_\_\_\_

b) eksperiencë \_\_\_\_\_

c) absolutizoj \_\_\_\_\_

d) abstenoj \_\_\_\_\_

Shkruaj fjalën ose kuptimin që ka fjala me kuptim të njëjtë e gjuhës shqipe:



**14.** Gjej ( shkruaj në vijën pran fjalës) bashkëtingëlloret e zëshme në fjalët e dhëna:

Breg \_\_\_\_\_

Hidhte \_\_\_\_\_

Qengj \_\_\_\_\_

Elb \_\_\_\_\_

**15.** Lexo fjalët e mëposhtme dhe thuaj cilat nga këto fjalë janë fjalë të parme:

1.

a) mal, fushë, flutur, këngë-a, muzik-a, këpucët

2. a) flutur-o-j, këngë-tar, ri-ndërt-im

b) këpucë+bërës, krye+qytet

c) dymbëdhjetë, megjithatë

Cilat nga fjalët nën pikën 2. janë fjalë të përngjitura:

**16.** Përmbi za që lshon bylbyli,

gjuha shqipe m' shungullon,

përmi er` që jep zymbyli,

pa da zemrën ma ngushllon.

.....

Geg' e tosk', malsi jallia

janë një komb m'u da s' duron;

fund e maj' nji a Shqipnia

e një gjuh` t' gjith' na bashkon.

Lexo me kujdes vargjet e sipërshtënuara dhe trego prej sa rrokjeve jenë përbërë këto vargje:

a) gjashtë rrokjeve;

b) dymbëdhjetë rrokjeve;

c) dhjetë rrokjeve;

d) tetë rrokjeve.

**17.** Ograja bleroshe,

Kodrina t`lulzue,  
 Ti njeti kërkoshe,  
 O shpezë e bekueme,  
 Njat kangë, jo me shfrye  
 S`a vend ky për tye.  
 “I tretuni” Ndre Mjedja

Detyra jote është të tregosh figurën stilistike që ka përdorur poeti në këto vargje. Cila është ajo?

- a) Krahasimi;
- b) Epiteti;
- c) Metafora;
- d) Onomatopea.

**18.** Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm, pastaj përgjigju pyetjes:

- Kishte kaluar kohë e gjatë që s`ishim parë. Takimi ishte i përmallshëm dhe emocional. Artës sytë i shkëlqenin si zambaku i pranverës, kurse Blerta ishte humbur në mendime dhe mendohej ta njihte, por vetëm një shenjë e vogël në fytyrë munda Blertën ta kthente në femijërine e saj. U përqaftuan dhe ashtu të shtrënguara mbetën për një kohe. Sa ishte rritur Arta. Jo, jo, ajo s`është engjell, është shoqja ime e fëmijërisë. Dhe derisa e shikonin njëra tjetrën Blerta e pyeti:

- Po ti Arta? - si ke kaluar këto vite?
- Po ke njohur shoqe të tjera?
- Po ke dashuruar dikë?
- Eh si të them...jeta qenka e vështirë.

Dallo motivin e paraqitur në tekstin e lartëshënuar dhe rretho përgjigjen e saktë:

- a) Motivin e njohjes
- b) Motivin e miqësisë
- d) Motivin e vetmisë.



**19.** Rirtregimi është:

- a) Zbërthimi i fjalëve ose i fjalive në pjesët përbërëse për të përcaktuar vlerat e tyre gramatikore, leksikore etj. veç e veç
- b) Përsërit me fjalët e mia, me shkrim ose me gojë, një pjesë të lexuar ose diçka të parë a të dëgjuar.
- c) Lloj tregimtar i prozës së shkurtër letrare a publicistike, në të cilin jepen, pa hyrë në analizën e lidhjeve të brendshme të gjërave, tiparet e një njeriu, të natyrës etj. ose përshkruhet një dukuri e jetës, një ngjarje
- Rretho shkronjën para përgjigjes së ritregimit:

**20.** Lexo me kujdes poezinë “Lulja e vetme” të Asdrenit dhe përgjigju pyetjeve:

Flenë kodrat nënë dritë  
 Tasaj hëne qeshëtare,  
 Ushëtijnë, përkëdhelen  
 Prej çdo ere udhëtare.

Ndaj thëllimet plotë vesë  
 Rron një botë porsi shkretë  
 Që ndë t'errët kërkon, hypën  
 Pak drië, pakë jetë.

Nd'atë heshtje të tmerruar  
 Qajnë shëlgjet me ngadalë,  
 Kur po sipër zjtë dridhen,  
 Shuhen, ndizen palë-palë.

Rreze t'arta me ëmbëlsirë  
 Çohin dritë kudo duhet;  
 Po një s'ndodhet e për lulen  
 Ndënë hijet që vdes, shuhet!

1. Lulja në këtë poezi është simbol:

- A) stinës së pranverës
- B) i rinisë dhe dashurisë
- C) i Shqipërisë së vetmuar dhe të robëruar

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

2. Trego cilat figura janë përdorur në këtë poezi:

---

# Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!  
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E paplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✗ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	